



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), nenin 37.3 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 04.08.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. DONJETË SHIJAKU** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Malishevë, nga subjekti politik "NISMA-Nisma për Kosovën" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Arbëreshë Krasniqi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Donjetë Shijaku dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 07.07.2020, Nr.665/2020, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Arbëreshë Krasniqi, pas dorëheqjes së saj të parevokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye se është zgjedhur deputete e Kuvendit të Kosovës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur e cila është, znj. Donjetë Shijaku, ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 04.08.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka